V E N D I M
Nr. 76, datë 11.2.1999

PËR RUAJTJEN DHE SHOQËRIMIN E PERSONALITETEVE TË LARTA SHTETËRORE DHE TRAJTIMIN ME PAGË TË EFEKTIVAVE TË KËTYRE SHËRBIMEVE

(Ndryshuar me VKM nr. 486, datë 21.10.1999; nr. 422, datë 12.9.2002)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të ligjit nr.7602, datë 9.9.1992 "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.8361, datë 1.7.1998, me ligjin nr.8421, datë 28.10.1998 dhe me ligjin nr.8452, datë 28.1.1999, me propozimin e Ministrisë së Rendit Publik, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. *Shfuqizuar.*
2. *Shfuqizuar.*
3. *Shfuqizuar.*
4. Anëtarëve të Këshillit të Ministrave, Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, Kryetarit të Gjykatës së Lartë, Kryetarit të Shërbimit Informativ Kombëtar dhe Kryetarit të Kontrollit të Lartë të shtetit u bëhet ruajtja e afërt fizike me shoqërues personal.
5. *Shfuqizuar.*
6. *Shfuqizuar.*
7. *Shfuqizuar.*
8. *Trajtimi me pagë bazë mujore i efektivit të Degës së Ruajtjes e Shoqërimit të Personaliteteve të Larta Shtetërore, bëhet sipas klasave i njëjtë me funksionet e tjera analoge në polici dhe me shtesë për vështirësi shërbimi":*

a) Për funksionet që merren drejtpërsëdrejti me ruajtjen dhe shoqërimin e personaliteteve të larta shtetërore, në masën deri në 350 për qind:

b) Për funksionet e tjera që shërbejnë në këtë repart, në masën deri 20 për qind më të lartë se funksionet analoge, që shërbejnë në strukturat e tjera të Ministrisë së Rendit Publik.

c) Efektivi i kësaj dege përfiton edhe çdo trajtim tjetër si të gjithë ushtarakët e sistemit të Rendit Publik, me përjashtim të pagesave për mbikohë pune e shërbimi.

Klasifikimi i funksioneve organike për efekt të caktimit të pagës bazë dhe shtesat për vështirësi shërbimi për çdo funksion përcaktohen nga Ministri i Rendit Publik.

9. *Shfuqizuar.*
10. *Shfuqizuar.*
11. Për efekt të zbatimit të këtij vendimi, në limitin organik të Ministrisë së Rendit Publik, shtohen 20 punonjës, të cilët u zbriten ministrive, sipas listës nr.1, që i bashkëngjitet këtij vendimi.
12. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 297, datë 22.7.1997 "Për ruajtjen e Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kryesisë së Kuvendit Popullor dhe Kryetarit të Këshillit të Ministrave pas lirimit nga funksioni" dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 592, datë 22.12.1997 "Për ruajtjen dhe shoqërimin e personaliteteve të larta shtetërore dhe trajtimin me pagë të efektivave të këtyre shërbimeve", ndryshuar me vendimin nr. 488, datë 29.7.1988, ndryshuar me vendimin nr.594, datë 19.9.1998, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

LISTA NR.1
NUMRI I PUNONJËSVE QË HIQEN NGA ÇDO INSTITUCION DHE MINISTRI

1. Kuvendi	2
2. Kryeministria (për Ministrin e Shtetit për Reformën Legjislative dhe Marrëdhëniet me Kuvendin	1
3. Gjykata Kushtetuese	1
4. Gjykata e Lartë	1
5. Prokuroria e Përgjithshme	1

6. Kontrolli i Lartë i Shtetit	1	
7. Ministria e Punëve të Jashtme	1	
8. Ministria e Drejtësisë	1	
9. Ministria e Financave	1	
10. Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit	1	
11. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale	1	
12. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit		1
13. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit		1
14. Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë		1
15. Ministria e Arsimit dhe Shkencës	1	
16. Ministria e Kulturës, Rinisë dh Sporteve	1	
17. Ministria e Shëndetësisë	1	
18. Ministria e Informacionit	1	
19. Shërbimi Informativ Kombëtar	1	
Shuma:		20